



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova  
Ministry of Foreign Affairs  
Diplomatic Academy - Diplomatska Akademija - Diplomatic Academy



PREMIER MINISTRE



## MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

### NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME,

REPUBLIKA E KOSOVËS

**DHE**

“ECOLE NATIONALE D’ADMINISTRATION” (ENA),

REPUBLIKA E FRANCËS

këtej e tutje të referuara si (“Palët”),

DUKE NJOHUR frymën e bashkëpunimit që ekziston ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Francës;

DUKE VLERËSUAR gatishmërinë për të promovuar bashkëpunim më të ngushtë në trajnimin e diplomatëve ndërmjet Akademisë Diplomatike të Republikës së Kosovës që gjendet në Ndërtesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, 10000 Prishtinë dhe Ecole Nationale d’Administration (ENA) që gjendet në Sainte Marguerite Street Nr. 1, F 67080 – Strasbourg – France;

Kanë rënë dakord si në vijim:

## **Neni 1 Qëllimi**

Objektivi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është që të krijojë kushtet për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimit të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

## **Neni 2 Bashkëpunimi**

Palët do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informatave dhe përvojave përkitazi me programet e tyre përkatëse të studimit, seminareve dhe aktiviteteve tjera akademike dhe të trajnimit.

Palët mund të eksplorojnë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit në kuadër të objektivave të këtij Memorandumi.

## **Neni 3 Çështjet me interes të përbashkët**

Palët do të nxisin, kontaktojnë dhe shkëmbejnë trajnerë dhe ekspertë në fushën e praktikës diplomatike dhe veçanërisht, si në vijim:

- Organizimin e sesioneve trajnuese nga ENA në Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës;
- Trajnimin e diplomatëve Kosovar nga ENA në Sesionet e saj të Shkurtra Ndërkombëtare të Specializuara në Administratën Publike (CISAP);
- Trajnimin e diplomatëve Kosovar nga ENA në Kursin e saj të Gjatë Ndërkombëtar (CIL) dhe Kursin e Trajnimit të Avancuar Ndërkombëtar;

## **Neni 4 Projektet e ndërmarra bashkërisht**

Palët do të vendosin specifikat dhe logjistikën e secilit projekt që ata ndërmarrin bashkërisht.

Për këtë qëllim, nëse është e nevojshme, do të nxirren protokollet që përcaktojnë termat dhe kushtet e shkëmbimeve të propozuara.

**Neni 5**  
**Kushtet financiare**

Për format, kohëzgjatjen dhe kushtet financiare të shkëmbimeve dhe trajnimit të përfaqësuesve do të bihet dakord ndërmjet Palëve.

**Neni 6**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur më interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve, përmes konsultimeve.

Dispozitat e këtij Memorandumi mund të ndryshohen përmes pëlqimit të ndërsjellë me shkrim ndërmjet Palëve.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të vazhdojë të ketë efekt për një periudhë prej tre (3) vjetësh. Pas kësaj, ky mund të ripërtërihet automatikisht për periudha të njëjta, përveç nëse ndërpritet nga ndonjëra Palë, duke i dhënë një njoftim me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve Palës tjetër, para datës së përfundimit të Memorandumit. Përfundimi i këtij Memorandumi nuk do të ndikoj në projektet që janë në vazhdim e sipër.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Memorandum.

BËRË në Paris, më 29.04.2016, në dy kopje origjinale, në Gjuhën Angleze, që janë njëlloj autentike.

Për Akademinë Diplomatike

të Republikës së Kosovës

Për “Ecole Nationale d’Administration”

të Republikës së Francës

---

**Skender Durmishi,**

**Drejtor, Akademia Diplomatike**

---

**Pierre Thenard,**

**Drejtor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ENA**